

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve të kërkesës ankimore nr. 17, 18, 19, 20”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, znj. J. Dumi.**

Znj. M. Çelmeta: Përshendetje!

Sot më datë 07 Nëntor 2024 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për 4 kërkesa ankimore. Kërkesa ankimore nr. 17, me ankues me ankues Partia Emigracioni Shqiptar, kërkesa ankimore nr. 18, me ankues Qendra Vendore Audiovizive Shkodër, kërkesa ankimore nr. 19 me ankues z. Besnik Dushaj dhe kërkesa ankimore nr. 20 me ankues z. Evdar Kodheli kanë si objekt: kundërshtimin e vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14, të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në 4 prej tyre janë shënuar kërkesat ankimore dhe një shirit letre është i bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Viojmë me futjen e shiritave. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre për caktimin e relatorit. Pasi përziejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjitës duke filluar nga:

- 1) z. Elvin Lako, 2) z. Elvis Çefa, 3) z. Ilirjan Rusmali, 4) z. Koli Bele, 5) z. Ledio Braho

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 07.11.2024*

Hapim goglën e parë dhe është kërkesa nr. 19.

Hapim goglën e dytë dhe është e bardhë, pa shënim.

Hapim goglën e tretë dhe është kërkesa nr. 17.

Hapim goglën tjetër dhe është kërkesa nr. 20.

Hapim goglën e fundit dhe është shënimi kërkesa ankimore nr. 18.

Në përfundim të procedurës së shortit:

Relator për kërkesën ankimore nr. 17 është zoti Ilirjan Rusmali.

Relator për kërkesën ankimore nr. 18 është zoti Ledio Braho.

Relator për kërkesën ankimore nr. 19 është Elvin Lako.

Relator për kërkesën ankimore nr. 20 është zoti Koli Bele.

Përfunduar me shortin, ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

